

# FINANCA

BULETINI MUJOR | DHJETOR 2024



## MINISTRI MALAJ, DEKLARATË PËR MEDIAT MBI AKTIN NORMATIV PËR BUXHETIN E VITIT 2024

Këshilli i Ministrave ka miratuar në një mbledhje të posaçme Aktin Normativ për disa ndryshime në Buxhetin e Shtetit për vitin 2024. Gjatë një deklarate për mediat, Ministri Petrit Malaj informoi se Ministria e Financave propozoi disa masa pas një analize të kujdesshme të ecurisë së ekonomisë dhe treguesve fiskalë për periudhën janar – nëntor 2024. Në këtë prag fundviti, tha Ministri, e gjithë vëmendja jonë shkon në mbështetje të shtresave më në nevojë,

kryesisht pensionistëve dhe familjeve me të ardhura të ulëta. Kështu, përmes Aktit Normativ u shpërndanë 2.2 miliardë lekë në formën e shpërblimeve të menjëhershme për disa nga kategoritë sociale më vulnerabil, si familjet që trajtohen me Ndihmë Ekonomike, Personat me Aftësi të Kufizuara dhe kujdestarët e tyre. Po ashtu, do të konkretizohet premtimin për garantimin e bonusit të Pranverës, duke siguruar krijimin e një llogarie speciale në Bankën e Shqipërisë, në mbështetje të pensionistëve në të cilën do të transferohet një fond prej 6.3 miliardë lekësh. Nga ana tjetër, me një fond shtesë në masën 1.4 miliardë lekë do të mbështeten fermerët, duke siguruar investim të vazhdueshëm për një nga sektorët më prioritarë të ekonomisë, bujqësinë.

LEXO MË SHUMË

## “REFORMA E PAGAVE KA PËRMBUSHUR OBJEKTIVIN, PAGA MESATARE NË SEKTORIN PUBLIK KA ARRITUR NË 987 EURO”

Qeveria ka përbushur reformën e rritjes së pagave në sektorin publik, duke siguruar një pagë më të lartë në sistemin arsimor, sistemin shëndetësor, sistemin e mbrojtjes dhe atë të sigurisë e të rendit. Gjatë një konference për shtyp mbi të dhënat e tregut të punës të publikuara nga INSTAT, Ministri i Financave tha se paga mesatare mujore për një të punësuar në sektorin publik ka arritur në 96,856 lekë ose 987 euro, rreth 15% më shumë në krahasim me

të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Po sipas të dhënave të INSTAT, paga mesatare mujore bruto e përgjithshme, e cila përfshin sektorin publik dhe sektorin privat, është rritur në rreth 77,669 lekë për tremujorin e tretë të vitit 2024, nga rreth 45,000 lekë që ishte në vitin 2013. Ministri Malaj theksoi faktin se reforma e pagave ishte një ndër prioritetet kombëtare, me një efekt financiar vjetor jo të vogël, rreth 40 miliardë lekë ose 400 milionë euro, ndërsa qëllimi kryesor i qeverisë ishte mbështetja e punësimit cilësor dhe vendi të kishte ndër pagat më konkurruese në rajon.



LEXO MË SHUMË



## PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS PARAPRAKË TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR PERIUDHËN 11-MUJORE TË 2024

Performanca paraprake e treguesve fiskalë të konsoliduar për periudhën Janar-Nëntor 2024 reflekton ecurinë e mbledhjes së të ardhurave dhe realizimit të shpenzimeve. Të ardhurat totale, për periudhën 11-mujore, arritën në rreth 647 miliardë lekë ose 100 % e planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, u mbledhën rreth 60.5 miliardë lekë më shumë ose 10.3 % më shumë se 11 mujori i vitit 2023. Shpenzimet e përgjithshme publike, për periudhën 11 mujore të vitit 2024, arritën në rreth 575.3 miliardë lekë me një realizim në masën 88.1% të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 ky zë ka rezultuar 4.8% më i lartë ose rreth 27 miliardë lekë më shumë. Në terma vjetorë, shpenzimet e përgjithshme për 11 mujorin e vitit 2024 u realizuan në masën 78% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 74.6% të planit vjetor sipas Aktit Normativ nr. 3 datë 28.08.2024.

LEXO MË SHUMË

## KUVENDI I SHQIPËRISË MIRATOI NEN PËR NEN PROJEKTBUXHETIN E SHTETIT PËR VITIN 2025



Kuvendi i Shqipërisë diskutoi dhe miratoi nen për nen në seancën plenare të datës 3 Dhjetor 2024 projektligjin “Për buxhetin e vitit 2025”. Fillimisht në seancë u paraqit raporti i komisionit për Ekonominë dhe Financat dhe

propozimet e paraqitura në raportet e komisioneve të tjera, të miratuara pas diskutimeve dhe dakordësisë me Ministrinë e Financave. Seanca vijoi me paraqitjen e amendamenteve dhe argumenteve të paraqitura nga deputetët dhe anëtarët e kabinetit qeveritar për secilin prej tyre. Gjatë diskutimeve, ministri i Financave, Petrit Malaj u shpreh se amendamentet e propozuara nuk janë të mbështetura financiarisht dhe nëse do të miratoheshin do të ndikonin në rritjen e borxhit publik dhe deficitit buxhetor. Pas diskutimeve, Kuvendi miratoi nen për nen dhe në tërësi me 75 vota pro, 24 kundër dhe 0 abstenim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2025”.

LEXO MË SHUMË

## KUVENDI I SHQIPËRISË MIRATOI AKTIN NORMATIV PËR KTHIMIN E KËSTEVE TË PARAPAGUARA TË TATIMIT FITIMIT NGA PROFESIONISTËT E LIRË



Kuvendi i Shqipërisë miratoi Aktin Normativ nr. 4, datë 27.11.2024 “Për një shtesë në ligjin nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, përmes të cilit bëhet i mundur kthimi i kësteve të parapaguara të tatimit fitimit nga tatimpaguesit që ofrojnë shërbime profesionale, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese e cila shfuqizoi skemën tatimore për përfshirjen në skemën progresive tatimore të furnizuesve të shërbimeve profesionale. Në fjalën e tij para deputetëve, Ministri i Financave theksoi faktin se, menjëherë pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, qeveria shprehu vullnetin e plotë për të adresuar kthimin e parapagimeve/kësteve të gjeneruara dhe të paguara nga tatimpaguesit që furnizojnë me shërbime profesionale, me qarkullim vjetor deri në 14 milionë lekë, tatimpagues të cilët tashmë kanë një normë tatimore 0% të Tatimit mbi Fitimin. Sipas të dhënave nga DPT, nga rreth 27.605 tatimpagues ofruer të shërbimeve profesionale që rezultojnë në total, për 19,468 tatimpagues do të fshihen detyrimet e gjeneruara si këste paraprake, ndërsa për 8,137 tatimpagues do të ndiqet procedura e rimbursimit. Ministri informoi se procesi i rimbursimit dhe fshirjes së detyrimeve për këtë kategori tatimpaguesish do të vijojë edhe gjatë vitit të ardhshëm.

LEXO MË SHUMË



## SHQIPËRIA RRIË KUOTËN E ANËTARËSIMIT NË FMN, MIRATOHET NË KUVEND PROJEKTLIGJI

Ministri i Financave prezantoi në seancën plenare të Kuvendit të Shqipërisë projektligjin “Për miratimin e rritjes së kuotës së Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar”. Në fjalën e tij, Ministri Malaj tha se rritja e

nevojshëm. Ministri theksoi se bashkëpunimi me FMN mbetet thelbësor, veçanërisht në garantimin e stabilitetit makroekonomik dhe në forcimin e kuadrit të politikave monetare e fiskale. Pas nënshkrimit të rritjes së kapitalit, vendi ynë do të zotërojë kuota pranë Fondit Monetar Ndërkombëtar në nivelin e 209 milionë SDR ose rreth 261 milionë euro. Projektligji u miratua pas prezantimit të Ministrisë dhe diskutimeve të deputetëve.

LEXO MË SHUMË

## TAKIM NDRËNINSTITUCIONAL - PREZANTOHEM RISITË E UDHËZIMIT STANDARD PËR PËRGATITJEN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMËSËM PËR NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE

Kuvendi i Shqipërisë miratoi në seancë plenare projektligjin “Për buxhetin faktik të vitit 2023”, i cili fillimisht u paraqit para deputetëve nga Ministri i Financave, Petrit Malaj. Ministri Malaj tha buxheti i vitit 2023 pati si objektiv madhor reduktimin e efekteve që solli lufta në Ukrainë, përmes

mbështetjes së shtresave në nevojë; mbështetjes së ndryshimit të çmimit të energjisë elektrike dhe për sektorin e energjisë në tërësi, si dhe ruajtjen e rritjes së qëndrueshmërisë së ekonomisë dhe konsolidimit fiskal. Ministri theksoi se, përmes politikave fiskale të kujdesshme në drejtim të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, gjatë vitit 2023 u siguroi një ulje e qëndrueshme edhe e stokut të borxhit publik, angazhim që vijon të jetë prioritet i punës së Ministrisë së Financave.



LEXO MË SHUMË

## “SHQIPËRIA KA BËRË PROGRES TË QËNDRUESHËM PËR TRANSPARËNCËN E FINANCAVE PUBLIKE, ËSHTË FORCUAR SISTEMI I RAPORTIMIT FINANCIAR”

Ministri i Financave mori pjesë në aktivitetin me temë “Ndërtimi i Besimit: Rruga e Shqipërisë në BE drejt Qeverisjes Transparente”, organizuar në kuadër të “Javës së Integritetit”. Në fjalën e tij, Ministri Petrit Malaj vuri theksin në rëndësinë e transparencës së financave publike dhe progresin që është arritur në vitet e fundit në këtë drejtim, i cili është konstatuar dhe nga shumica e organizmave ndërkombëtarë monitorues. Ministri tha se Ministria e Financave ka rritur në mënyrë të vazhdueshme transparencën, duke e përcjellë informacionin më cilësor dhe më të kuptueshëm për publikun e gjerë. Financat Publike, tha Ministri, janë një shtyllë kyçe në dobi të transparencës publike.

Publike dhe Kontabilitetin (CIPFA), si dhe Programin për Mbështetjen e Përmirësimit të Qeverisjes dhe Menaxhimit (OECD Sigma). Qëllimi i tij ishte përmirësimi i sistemeve të auditimit të brendshëm në Shqipëri dhe mbështetja e reformave që janë thelbësore për negociatat e anëtarësimit në Bashkimin Europian. Ministri Malaj theksoi rëndësinë e funksionit të auditimit të brendshëm sa i përket sigurimit të përdorimit efektiv të burimeve publike dhe ruajtjen e besimit të publikut tek institucionet, në një kohë që ndër vite janë bërë përpjekje të rëndësishme për të përmirësuar sistemin e auditimit të brendshëm në të gjitha institucionet qeveritare.

LEXO MË SHUMË



## PËRMIRËSIMI I SISTEMEVE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM/PËRFUNDON PROJEKTI PËR TRAJNIMIN E AUDITORËVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK –TIAPS

Ministri i Financave mori pjesë eventin e organizuar në përfundim të Trajnimit për Trajnimin e Auditorëve të Brendshëm në Sektorin Publik –TIAPS. Projekti u zbatua nga Ministria e Financave, në bashkëpunim me Qendrën për Ekselencë në Financa nga Slovenia, Institutin e Certifikuar për Financat

miratuar”, i ndryshuar”. Ndryshimet ligjore janë propozuar në kuadër të përafërimit të mëtejshëm të kuadrit rregullator të fushës me acquis communautaire dhe si rrjedhojë e zbatimit të një sërë reformave të rëndësishme të ndërmarra nga Ministria e Financave, që lidhen me përmirësimin e raportimit financiar në vend në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare, duke synuar përmirësimin e kornizës ligjore dhe rritjen e cilësisë së raportimit financiar në vend. Pas prezantimit të Ministrisë dhe diskutimit të deputetëve, projektligji u miratua nga Kuvendi.

LEXO MË SHUMË



## MIRATOHEN NË KUVEND NDRYSHIMET NË LIGJIN PËR AUDITIMIN LIGJOR, ORGANIZIMIN E PROFESIONIT TË AUDITUESIT LIGJOR DHE TË KONTABILISTIT TË MIRATUAR

Ministri i Financave prezantoi në seancën plenare të Kuvendit të Shqipërisë projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10 091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të

miratuar”, i ndryshuar”. Ndryshimet ligjore janë propozuar në kuadër të përafërimit të mëtejshëm të kuadrit rregullator të fushës me acquis communautaire dhe si rrjedhojë e zbatimit të një sërë reformave të rëndësishme të ndërmarra nga Ministria e Financave, që lidhen me përmirësimin e raportimit financiar në vend në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare, duke synuar përmirësimin e kornizës ligjore dhe rritjen e cilësisë së raportimit financiar në vend. Pas prezantimit të Ministrisë dhe diskutimit të deputetëve, projektligji u miratua nga Kuvendi.

LEXO MË SHUMË